



PRISHTINA



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË
GJP "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISHTINA
MPE "BUS STATION" J.S. PRISHTINA

Në pajtim me nenin 21. të Ligjit, Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrje Publike (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.31/2018), Bordi i Drejtorëve të NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur me datë 07.12.2023 mori këtë:

V E N D I M

- I. Anulohet Konkursi nr.02/1680 dt.18.10.2023 për pozitat e zyrtarëve të lartë, për Kryeshef Ekzekutiv, Zyrtar Kryesor Financiar dhe Thesarit dhe Sekretar në NPL Stacioni i Autobusëve Sh.a Prishtinë i publikuar me datë, 19.10.2023.
- II. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

Arsyetim

Bordi i Drejtorëve të NPL Stacioni i Autobusëve sh.a Prishtinë, bazuar në përgjigjësitë dhe kompetancat ligjore me datë 18.10.2023 ka shpallur konkurs publik për plotësimin e pozitave të larta të përcaktuara me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, atë të Kryeshefit Ekzekutiv, Zyrtarit Kryesor Financiar dhe i Thesarit si dhe pozitën e Sekretarit të Ndërmarrjes.

Bordi i Drejtorëve të NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh. A. pas shpalljes së konkursit, me datën 27.11.2023 ka vlerësuar aplikacionet e kandidatëve dhe i ka ftuar për intervistim kandidatët e përzgjedhur në listën e kandidatëve që i kanë plotësuar kriteret ligjore Me qëllim që të mos ketë pengesa ligjore për emërim, kanë marrur edhe një opinion juridik nga UD Sekretari, e i cili deklaroi se nuk ka asnjë konflikt të interes për njërin kandidat të kualifikuar

Para mbajtjes së intervistave, me datën 03.12.2023 dy anëtarë të Bordit kanë kërkuar opinion ligjor nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, lidhur me pengesat ligjore të emërimit për njërin nga kandidatët që ishin ftuar në intervistim. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit me datën 04.12.2023, përmes emailit zyrtar ka përcjellë një përgjigje të përgjithësuar, e cila me datë 05.12.2023 i është përcjellur Bordit të Drejtorëve nga njëri anëtar i saj, në të cilën ka njoftuar se të gjithë të ish emëruarit, nuk kanë të drejtë të zgjedhen në pozita të larta në Ndërmarrje Publike,

deri në 2 vite, pas përiudhes së përfundimit të emërimit si zyrtar i lartë publik.
Por, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, nuk ishte përgjigjur në pyetjen themelore nëse pozita e ish anëtarit të Bordit të Përkohshëm, ka pengesa ligjore për emërim në pozita të larta të Ndërmarrjes.

Po ashtu, kryesuesja e Bordit, me datën 06.12.2023 kishte pranuar një email në të cilin ishte njoftuar përmes dokumentacioneve të bashkangjitura se njëri nga kandidatët e përzgjedhur për intervistim për dy pozita të larta të shpallura, kishte pengesa ligjore për emërim.

Duke marr parasysh këto fakte, Kryesuesja e Bordit, me datën 06.12.2023 në ora 10:00 kishte ftuar mbledhjen e jashtëzakonshme të Bordit për të diskutuar lidhur me gjendjen e krijuar me qëllim që Bordi të njoftohet me gjendjen dhe të merr veprime adekuate me qëllim që procedurat e emërimit të zhvillohen në pajtim me legjislacionin në fuqi. Takimi i Bordit i thirrur për ora 10:00 kishte dështuar për shkak të korrupsionit sepse dy anëtarë të Bordit nuk kishin marr pjesë në mbledhje.

Duke parë seriozitetin e çështjes, Kryesuesja e Bordit, po të njëjten ditë, në ora 13:00 kishte ftuar për herë të dytë anëtarët e Bordit për të marrur pjesë në mbledhjen e jashtëzakonshme. Edhe herën e dytë, në mungesë të korrupsionit, mbledhja përsëri kishte dështuar.

Kështu, është bërë thirrje për mbledhjen e tretë urgjente, e cila është thirrur në të njëjtën ditë, 06.12.2023 në ora 15:00, por edhe kjo mbledhje ka dështuar, në mungesë të korrupsionit.

Gjendur përballë një situatë të jashtëzakonshme, ku kishin mbetur vetëm pak orë deri në fillimin e intervistimit të kandidatëve, ku në mesin e të cilëve ishin edhe kandidatët që pretendohet se nuk plotësonin kriteret ligjore, ndërsa në anën tjetër në mungesë të korrupsionit për të trajtuar çështjen me seriozitet, kryesuesia e Bordit detyrohet t'iu drejtohet Komisionit Komunal të Aksionarëve, nga i cili kërkon ta udhëzoj si të veprojnë përballë këtij ngërçi të krijuar.

Komisioni Komunal i Aksionarëve, pas takimit të jashtëzakonshëm të tyre, përmes emailit i bënë thirrje Bordit të Drejtorëve që të ndërmirren të gjitha veprimet e nevojshme që procedura e intervistimit të kandidatëve të bëhet në pajtim të plotë me legjislacionin në fuqi, duke garantuar që të gjithë kandidatët që ftohen në intervistë t'i kenë të plotësuar kriteret ligjore dhe të njëjtit të mos kenë pengesa ligjore për emërim. Ata gjithashtu rekomandojnë që intervistimi të shtyhet të paktën për një ditë dhe Bordi t'i evitojë të gjitha pengesat ligjore të cilat mund të kenë pasoja për dëmtim të procesit.

Pas rekomandimeve të KKA, dy antaret e Bordit që iu përgjigjen vazhdimisht thirrjes për mbledhje të jashtëzakonshme, me qëllim të mos lejohet të ndërhyet në process gjatë ose pas përfundimit të të intervistuarëve, vendosën që të shtyhet për të paktën një ditë intervistimi i kandidatëve dhe u thirr edhe një mbledhje tjetër e Bordit të Drejtorëve për datën 07.12.2023.

Duke u mbështetur në rrjedhjen e këtij procesi, që nga shpallja e konkursit e deri në kualifikimin e kandidatëve për tu ftuar në intervistë, pasi që ishin kualifikuar kandidatë, për të cilët ishin ofruar fakte se kishin pengesa ligjore për emërim si dhe nuk kishte opinion ligjor të qartë nga

organet kompetente lidhur me te drejtën e ish anëtarëve të Bordit të Përkohshëm që te jenë apo jo kandidatë të kualifikuar për emërim, ndërsa në anën tjetër kishte edhe një opinion nga UD Sekretari se nuk ka asnjë konflikt ineters, atëherë me qellim që procesi të jetë në ligjshmëri të plotë i hapur, transparent dhe i barabart për të gjithë të interesuarit, Bordi i Drejtorëve me datë 07.12.2023 me shumicë votash vendosi të anuloi konkursin nr.02/1680 dt. 18.10.2023, dhe rrjedhimisht u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi palët e paknaqura mund të ushtrojnë ankesë në Gjykatën kompetente në afatin vijues prej 15 ditësh nga dita e publikimit të këtij vendimi në web faqen zyrtare të SAP-it..

Ti dërgohet:
1x1.Bordit të drejtorëve
1x1.Dep.juridik
1x1.Arkivit

Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve

Sarande Sadriu

